

**Standard që
krijon shqarje**

Zgjidhja juaj për shkathtësi digjitale



ECDL: zgjidhja juaj për shkathtësi digjitale

Zhvillimi i hovshëm i TIK-ut ka ndikuar në shumë ndryshime të cilat kanë ndodhur në jetën dhe punën tonë. Ka ndryshuar mënyra se si punojmë, informohemi, komunikojmë, ndërveprojmë, socializohemi e argëtohemi. Por, ndryshime edhe më të mëdha pritjet të vijnë në vitet e ardhshme.

E ashtu siç ndryshon teknologjia dhe ndërveprimi i njerëzve me të, ashtu ndryshojnë edhe aftësitë që ne duhet t'i zotërojmë, për të qenë në gjendje të jemi efikas në punën tonë dhe për të marrë pjesë plotësisht në shoqëri.

Sipas vlerësimeve të Komisionit Evropian nga 2015 e tutje për 90% të vendeve të punës do të nevojiten shkathtësi bazike të TIK-ut.

Këto zhvillime, dhe ndryshimet në mënyrën se si ne tani fitojmë dhe zhvillojmë aftësi, kanë çuar në zhvillimin dhe avancimin e programit certifikues të ECDL-së.


ECDL është një certifikim progresiv dhe fleksibil për zhvillimin e shkathtësive digjitale të individëve. ECDL është standardi kryesor ndërkombëtar i certifikimit të njohurive kompjuterike. Programet e ECDL-së janë të ndërtuara në mënyrë modulare. Me përfaqësi në mbi 150 shtete të botës dhe me mbi 13 milion kandidatë, ECDL është standardi më i përhapur në botë dhe me rritjen më të shpejtë.

Shkathtësitë e përdorimit të kompjuterit ju ndihmojnë të punoni më shpejtë, në mënyrë më eficiente dhe me më pak gabime. Certifikimet e ECDL-së janë dëshmia më e mirë për punëdhënësit se ju i posedoni këto shkathtësi.

Shkathtësitë digjitale ju mundësojnë individëve të të gjitha moshave ta përdorin teknologjinë informative dhe të komunikimit në mënyrë që të përmirësojnë jetët e tyre personale dhe profesionale.

Si t'i përfitoni aftësitë që ju duhen - përmes niveleve të ndryshme të trajnimit dhe certifikimit

Trajnimi dhe certifikimi në ECDL është i mundshëm në tri nivele:



Certifikata ECDL Base dëshmon nivelin fillestar të njohurive, ndërsa certifikata ECDL Standard, që e përfshin nivelin ECDL Base + 3 module të nivelit Standard, dëshmon nivelin e njohurive dhe shkathtësive ekuivalente me relevancën e shumicës së vendeve të punës. ECDL Expert paraqet nivelin më të avancuar të njohurive dhe shkathtësive digjitale.



ECDL për Jetë

Shkathtësitë e fituara përmes programeve të ECDL-së ju ndihmojnë individëve që në mënyrë të lehtë dhe eficiente të komunikojnë dhe bashkëveprojnë me të tjerët. Kjo nënkupton komunikim më të lehtë me shokë dhe familje, lidhje me komunitete virtuale e rrjete sociale përmes përdorimit të veglave dhe aplikacioneve adekuate, përdorimin e shërbimeve të blerjes online, votimit online, mësimin online, punës nga distanca e pjesëmarrjes në shoqëri.

Komunikimi, lidhja dhe ndërveprimi është i mundshëm, i lehtë dhe i sigurt – falë shkathtësive të fituara nga programet e ECDL-së.

ECDL për Punë

Në ditët e sotme është shumë e rëndësishme që punëtorët të kenë aftësi për t'i përdorur teknologjitë informative dhe komunikuese, pasi që këto teknologji janë të domosdoshme në shumicën e vendeve të punës. Punëdhënësit kërkojnë nga punëtorët të jenë të aftë të përdorin kompjuterin në mënyrë efektive dhe eficiente për të kontribuar në arritjen e qëllimeve afariste. Kandidatët që kërkojnë punë gjithmonë ballafaqohen me kërkesa për dëshmi të aftësive kompjuterike. Me certifikatat e ECDL-së kandidati për punë ka një provë për nivelin e kompetencave dhe aftësive të kërkuara, rrjedhimisht mundësitë për punësim i ka më të mëdha. Shkathtësitë e fituara në programet e ECDL-së ju ndihmojnë individëve të jenë më efikas në kryerjen e detyrave, të shquhen për profesionalizëm, të tregojnë më shumë potencial për zhvillim dhe të përparojnë më shumë në karrierë. ECDL ka ndihmuar mbi 11 milion njerëz anë e kënd botës të demonstrojnë aftësitë e tyre dhe të fitojnë përparësi konkurruese në tregje të punës.

Certifikatat e ECDL-së janë mënyra më e mirë për të dëshmuar posedimin e shkathtësive digjitale dhe për tu veçuar nga të tjerët.

Dobitë për Individët

ECDL është i dizajnuar që t'i ndihmoj njerëzit në punë dhe në shtëpi. Dobitë kryesore të programeve të ECDL-së për individë janë:

- Pajisje me dije dhe shkathtësi relevante
- Përmirësim i vërtetuar i produktivitetit
- Rritje e mundësive të punësimit dhe karrierës
- Kualifikim i verifikueshëm i kompetencave
- Qasje e sigurt dhe e barabartë në shoqëri
- Standard ndërkombëtarisht i njohur
- Dëshmi ndërkombëtarisht e garantuar e aftësive

"ECDL më ka ndihmuar të jem më efkase dhe më produktive në punë dhe jetë. "

Leonida Gashi, Punonjëse Administrate

"Falë njohurive të fituara nga modulet e ECDL-së kam arritur të jem më produktivë dhe të kem më shumë vetbesim në të gjitha detyrat me të cilat përballem."

Gëzim Dobruna, Project Leader

"Njohuritë e fituara nga ECDL dhe certifikata ndërkombëtarisht e njohur e ECDL-së më ndihmuar në gjetjen e punës në një kohë kur konkurrenca për një vend të punës është shumë e madhe."

Fatbardha Demolli

Për ne

ECDL Kosova është autoriteti nacional certifikues i autorizuar nga ECDL Foundation për Republikën e Kosovës. ECDL Foundation është autoriteti mbikëqyrës i programeve certifikuese, ndërkombëtarisht prijëse, të shkathtësive kompjuterike – ECDL/ICDL. Cilësia dhe reputacioni i programeve tona certifikuese janë të ndërtuara mbi përvojën e gjatë në shpërndarjen e suksesshme të programeve certifikuese të TIK-ut miliona njerëzve anembanë botës në më shumë se 41 gjuhë të ndryshme dhe në mbi 150 shtete.

Suksesi global i ECDL-së rrjedh nga roli ynë nismëtar në identifikimin dhe zhvillimin e programeve si dhe përkushtimin tonë për të siguruar metodologji testuese që, në mënyrë të vazhdueshme, i zbatojnë standardet më të larta të cilësisë.

Programet certifikuese të ECDL-së në Kosovë janë të njohura nga Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve, Universitetet Publike dhe Private dhe një numër i madh i organizatave dhe institucioneve private e publike (Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Ministria e Administratës Publike, Ministria e Pushtetit Lokal, Policia e Kosovës, FSK, Inspektorati Policor, Autoritetet Rregulluese, Firma e Organizata private e jo-qeveritare).

Qeveria e Republikës së Kosovës dhe Ministria e Integritimit Evropian përmes planit për veprim PVPE 89/2 e pozicionon ECDL-në si standard certifikues për të gjithë shërbyesit civil. MASHT, duke filluar nga viti 2009 e ka përfshirë certifikimin ECDL Standard si masë obliguese për licencim për të gjithë mësimdhënësit e shkollimit para-universitar.

A mund të ju ndihmojmë?

Për çfarëdo informate shtesë jemi në dispozicionin tuaj në çdo kohë.

Ne mund të na gjeni në këtë adresë:

ECDL Kosova SH.A.

Rruga Xheladin Hana p.n. – Bregu i Diellit

10000 Prishtinë

Internet: www.ecdl-kosova.org Email: admin@ecdl-kosova.org Phone: 044-507 575